



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMJENQ DANA:		20.07.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT SR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS DR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-052/01-83551			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Raport nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës në qershor të vitit 2026

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton raport nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për periudhën janar-qershor 2026 i cili është mbajtur me datën 26.06.2026, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 10:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziata e Udhëzimit administrativ (MAPL) për Administratë të Hapur në komuna.

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/25115-1-1.pdf>

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	
2. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	

Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë **60** pjesëmarrës, prej tyre **23** femra dhe **37** meshkuj.

Takimi i cili është mbajtur me 26.06.2026 duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit Komunal kishte karakterin informues për të gjithë pjesëmarrësit. Përfaqësuesit e komunës kanë njoftuar për aktivitetet komunale, të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhes për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit paten rastin të bëjnë pyetje dhe të japin propozime lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të tyre dhe gjithë qytetarëve të tjerë.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoi kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti ku takimin e filloi duke i njoftuar të pranishmit për punën gjatë periudhes janar-qershor 2026 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe.







Kryetari Imri Ahmeti në fillim të këtij takimi është shprehur i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku theksoi se aktualisht janë duke u zhvilluar në teren shumë projekte investime vetanake nga komuna dhe projekte të tjera së bashku me partner.



Kryetari Imri Ahmeti, në vazhdim të kësaj mbledhje ka prezantuar realizimin e të hyrave vetanake, ku deri më tani është realizuar 48.32% e planifikimit vjetor. Veçanërisht u theksua realizimi i tatimit në pronë i cili ka arritur në 32.22%.

Ndërsa për projektet kapitale, ai tha se aktualisht janë në proces disa projekte, ku një pjesë e tyre është duke u zbatuar në terren, ndërsa të tjerat ndodhen në fazat e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, me pritshmëri që shumë shpejt të fillojnë punimet”, tha Kryetari, z. Imri Ahmeti.

Gjithashtu Kryetari Ahmeti ka theksuar edhe investimet në infrastrukturë, prioritet i veçantë do t’u kushtohet edhe sektorëve të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, sportit, kulturës dhe rinisë, për të cilët janë realizuar projekte të rëndësishme dhe janë ndarë subvencione. Mbështetja për këta sektorë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Qytetarët e pranishëm në takim shprehën mirënjohje për angazhimin e Kryetarit Ahmeti dhe kabinetit të tij për realizimin e projekteve të shumta që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e komunës.

Ata gjithashtu paraqitën kërkesa për investime të reja kapitale në të ardhmen.

Në përmbyllje të takimit, Kryetari Ahmeti falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e qeverisjes së hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente në shërbim të qytetarëve.

Po ashtu qytetarët prezent kanë pasur rastin të bëjnë pyetje rreth shumë çështjeve me rëndësi të marrin përgjigje nga vet kryetari Imri Ahmeti

Pastaj Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, e hapi diskutimin për të pranishmit.

Në përmbyllje të takimit Kryetari Ahmeti, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e një qeverisjeje të hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente, në shërbim të qytetarëve.

Pasi çështje të tjera nuk kishte mbledhja perfundoi ne ora **12:15**

Pastaj Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, e hapi diskutimin për të pranishmit.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Ka thënë se janë bërë punime të shumta në Janjeve dhe ju jemi mirënjohës por ju e dini që ka qenë edhe premtim rregullimi i rrugës Janjeve-Teqe-Shushicë e cila nuk ka gjatësi të madhe afër 2 klm.	Fehmi Gajtani, Janjeva	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se falë investimeve të bërë deri me tani gjendja me infrastrukturë është përmirësuar dukshëm, kanë mbetë të pa asfaltuara vetëm disa rrugica nëpër fshatra ndërsa rrugët kryesore janë përfunduar në të gjitha vendbanimet. Ndërsa rruga Janjeve Teqe që ndërlidhet me fshatrat Shushicë do të realizohet shpejtë.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Ka theksuar problemet në infrastrukturë si kyçja e disa rrugëve dhe rëndësinë e investimeve në Gadime për shkak të vendit turistik.	Sylbije Sahiti,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të investojë në secilin fshat duke u nisur nga prioritetet dhe duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Tha se po e ritheksojë problemin e objektit të shkollës së vjetër në Banullë i cili nuk është në gjendje të mirë. E di që janë premtuar investime edhe nga ministritë por deri tani nuk ka asgjë në atë drejtim, kërkojmë nga	Afrim Hajrullahu,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës , tha se po shkolla e vjetër në banullë dhe Dobrajë e Madhe do të intervenojmë së shpejti në to.	Komenti u pranua Plotësisht

	komuna ta bëjë të mundurën që ajo shkolle të rinovohet.			
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Tha se rrugët të cilat janë ndërtuar duhet të kenë edhe ndriçim dhe sinjalizim.	Albert Bublica,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës, kryetar i komunës, tha se do të mundohemi ti kompletojmë të gjitha rrugët kryesore me ndriçim dhe sinjalizim.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Tha se në fshatin Grackë ka nevojë për ndriçim publik, trotuarë, rregullimi i një hapësirë publike për këndin e lojrave dhe projekte të tjera.	Ali Sopa,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se janë bërë disa investime në Grackë, por do të planifikohen edhe kërkesa tjera që dalin nga banorët duke u nisur nga ato më prioritare.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Tha se në fshatin Qylagë, janë edhe disa punë për tu bërë si, rregullimi i shtratit të lumit dhe projekti i ujësjellësit nga Magurja.	Gëzim Bytyqi,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se do të marrë parasysh kërkesat që ti propozojmë në planifikimin e buxhetit që jemi në hartim e sipër.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Në Magurë a do të vazhdojnë projektet në ndërtesat që janë përfunduar me izolim.	Agim Emini,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se sa i përket projektit për izolimin e banesave është projekt me i gjatë tash së shpejti po fillojmë të ndërtesa përball stacionit policor do të ndërtohen lift dhe do ti ndërrohet kulmi.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	tha se kam dy kërkesa e para problemi me ujë të pijes si dhe rrugët brenda fshatit janë dëmtuar në masë të	Fahri Zeqri,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se do të marrë parasysh kërkesat që ti propozojmë në planifikimin e buxhetit	Komenti u pranua Plotësisht:

	madhe në fshatin Sllövi.		që jemi në hartim e sipër.	
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Ka kërkuar zgjerimin e rrugëve në fshatin Ribar i Vogel dhe te trotuarit.	Nystret Kelmendi	Imri Ahmeti, kryetar i komunës, Komuna e Lipjanit të gjitha projektet e propozuara nga ana e qytetarëve i planifikon në buxhet sipas prioriteteve të tyre, andaj organizohen edhe dëgjimet buxhetore që të merren të gjitha propozimet e fshatrave dhe lagjeve dhe ato me kryeore të futen në buxhet	Komenti u pranua Plotësisht:
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	kërkesë për zgjerimin e rrugës Dobraje Lluga dhe shenjëzimi i rrugës.	Nazmi Krasniqi,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se të gjitha kërkesat e dalura nga qytetarët do merren parasysh dhe sipas prioriteteve do të futen në buxhet.	Komenti u pranua Plotësisht:
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	Ka kërkuar që një rrugë mbrapa lagjes Dino në Lipjan, pas ndjekjes së procedurave sipas rekomandimit të komunës nga pronari kemi marrë pëlqimin e noterizuar për lejimin e shtrimit të rrugës pa asnjë kompensim. Mirëpo, ai pëlqim ka një afat dhe ju lusim që brenda këtij afati të asfaltohet rruga, në mënyrë që të mos mbesim edhe më	Fehmi Gajtani,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës, e kam të qartë situatën tuaj dhe ajo rrugë është në proces të shtrimit. Arsyeja e vonësës është se operatorët që kemi të kontraktuar e kanë neglizhuar punën për shkak të rritjes së çmimit për metër kub të asfaltit, si pasojë e krizave të fundit globale dhe shtrenjtimit të derivateve. Sapo të kontraktojmë një operator të ri ose të vazhdojmë me operatorin aktual, ajo	Komenti u pranua Plotësisht:

	gjatë peng dhe të mos ndryshojë mendje pronari.		rrugë do të shtrohet, ashtu siç kam premtuar.	
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2026	tha që të bëhet zgjerimi i rrugëve që lidhen me magjistralë.	Gazmend Sylejmani,	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se rruga e Konjuhit zakonisht e ngarkuar por shpresojmë që shkarkohet shpejt ajo rrugë, sepse tash do e rishikojmë mundësinë që disa rrugë njëkahëshe ti bëjmë dy kahëshe të intervenojmë në shkakrimin e rrugëve më të ngarkuara.	Komenti u pranua Plotësisht:

Në fund kryetari i komunës Imri Ahmeti i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e një qeverisjeje të hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente, në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Shtojcë: lista e pjesëmarrësve
Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun

Bukurie Zejnullahu -Jashari

Lipjan, 20.07.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

Datë: 26.06.2024

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Mbledhja publike e Kryetarit me qytetarët e Komunës së Lipjanit

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Belkum	Krasniqi - YAHIR	
2	Fehmi	Gajrani	
3	Skender	Gashi	
4	Hamadan	Gashi	
5	Ilir	Xhemshiti	
6	Avni	Azemi	
7	Laudim Rra	Rizani	
8	Myret	Kolmanoli	
9	RAMIZ	GASHI	
10	Izaim	Latifi	
11	Gëzim	Bytyqi	
12	FEHMİ GATTAN	GATTANI	
13	Artinaresa	Karpuzi	
14	Edona	Hajolime	
15	Gjyltene	Billegi	
16	Asbnoza	Gashi	
17	Donita	Bytyqi	
18	ENHIGER	Bytyqi	
19	Sylbiq	Salenti	
20	Mehol	Avdyli	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

Datë: 26.06.2024

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Mbledhja publike e Kryetarit me qytetarët e Komunës së Lipjanit

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	ARMEND	ALIV	
2	LEOTIM	EMINI	
3	SIYATU	SHABANI	
4	Imet	Almeti	
5	Gatmend	Seferi	
6	Nazmi	Krasnigj	
7	Perpaim	Ghaler	
8	Menta	Zegni	
9	Afrim	Pacoll	
10	Fahri	ZEQIRI	
11	Milezim	Sholer	
12	ALBERT	BABLIĆA	
13	Shekate	Dedushë - Gosh	
14	Abidin	Ilut TEREK	
15	AFRIK	HASRULLIĆ	
16	ALI	SOPA	
17	AJNA	VITAJA	
18	Mirjeta	Gashi	
19	Arbnora	Marevci	
20	Zeg	Çmani	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 26.06.2024

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Mbledhja publike e Kryetarit me qytetarët e Komunës së Lipjanit

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Ullahim	Xhemaj	
2	Qerim	Fazliu	
3	Beshik	Dachari	
4	Ysidon	Zejneshkahu	
5	Menir	Mustafaj	
6	KAZ	BEDROV	
7	PERPARIM	- Olluzi	
8	Kosovare	Vunizi	
9	Leunora	Azemi	
10	Besim Kastrati	Kastrati	
11	Selibe	HASHANI	
12	Antigona	Krasniqi	
13	Ganimete	HOTI	
14	Fatma Sinani	Sinani	
15	Shosa	Aliu	
16	Shona	BERO	
17	AGIM EMIRI	Priz	
18	Kamir	Redinovic	
19	Emilona	Veriqi	
20	Adelina	Tomara	